



VENDIM I BORDIT TË FBK-së i DATËS 24.07.2024, Prishtinë

Bazuar në kompetencat e Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) që dalin nga Statuti, gjegjësisht Neni 23, alineja 1.3, si dhe në përputhje me Rregulloren e Punës së Bordit të FBK-së, më 24.07.2024, pas pranimit të draft-propozimeve, Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës ka marrë vendim që të miratoj:

1. Rregulloren për Licencim dhe Garim të FBK-së, Edicioni 2024/25;
2. Kriteret për Licencim të Klubeve në FBK për edicionin 2024/25;
3. Formularin për aplikim dhe materialet përcjellëse për aplikantët.

Sipas afateve të përcaktuara në dokumentin 'Kriteret për Licencim të Klubeve në FBK për edicionin 2024/25', periudha e hapur për aplikim është 29 Korrik deri 23 Gusht 2024. Rrjedhimisht, ftohen të gjitha klubet e Superliga Meshkujt, Superliga Femrat, Liga e Parë Meshkujt dhe Liga e Parë Femrat që të dorëzojnë aplikimet e tyre për licencim pranë FBK-së.

Licencimi i klubeve dokumentohet me vendim të Bordit të FBK-së para fillimit të edicionit të ri.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Arben **FETAHU**

Federata e Basketbollit të Kosovës



Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

